

# Udhëtimi me një varkë letre ?

## Materialet dhe pajisjet:

- një kapëse letre/klip
- një gotë uji
- letër kartoni
- një laps
- një gërshërë
- larës enësh
- një tas i madh i pastër, i mbushur me ujë çezme

### „Paraprakisht“

Mbushni gotën plot deri tek buza me ujë, pastaj vendosni me shumë kujdes një kapëse letre mbi sipërfaqen e ujit.

Çfarë do të ndodhë me kapësen e letrës?

Ajo do të notojë mbi sipërfaqe.

Ajo do të fundoset, do të bie poshtë.



### A e dini pse?

Kapëseja e letrës do të notojë në sipërfaqen e ujit , sepse tendosja sipërfaqësor e ujit është mjaft e lartë për të mbartur në sipërfaqe objekte kaq të lehta e të vogla.

### Përgatitja :

1. Vizatoni një varkë në letër dhe prejeni atë .
2. Mbush një tas të madh me ujë dhe vendosni varkën mbi sipërfaqen e ujit dhe lëreni të lundrojë në tas.
3. Zhyteni gishtin tregues në ujë pikërisht prapa varkës.
4. Çfarë do të ndodhë?



---

## Udhëtimi me një varkë letre?

Vendosni një pikë larëse enësh në gishtin tregues dhe zhyteni atë pas varkës në ujë..

### Vëzhgoni:

---

---

A keni ju një ide pse mund të ndodhë kjo?

➡ Mos ka të bëjë me tendosjen sipërfaqësore!

---

---



### Cfarë është tendosja sipërfaqësore?

Uji është i përbërë nga grimca shumë të vogla të quajtura molekula uji. Molekulat lidhen së bashku shumë fortë me njëra-tjetrën e kështu formojnë një „lëkurë“ në sipërfaqen e ujit.



Kjo lëkurë, bën të mundur si p.sh. që disa insekte të ecin mbi ujë. Molekulat e ujit, dmth grimcat e vogla të ujit, kanë zona me ngarkesë, pozitive e negative të cilat tërheqin njëra tjetrën. Si rezultat i këtyre lidhjeve krijohet në sipërfaqe një cipë e fortë, e cila vepron si një „lëkurë“ e qëndrueshme .

Ju mund ta vëreni shumë mirë se si duket tendosja sipërfaqësore e ujit, po ta provoni me monedhën 1€.



Filmin mund ta gjeni në adresën/linkun e mëposhtëm:

<https://www.youtube.com/watch?v=Eo6imkTJaXA>